





BASHKIA
DURRËS

RAPORTI I PERFORMANCËS 2024



Ky botim u mbështet nga ‘Bashki të Forta’, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues	4
Qëllimi i Raportit.....	8
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	8
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	12
SHËRBIME PUBLIKE VENDORE.....	13
 Arsimi Parauniversitar	13
 Menaxhimi i Mbetjeve	15
 Mbrojtja nga zjarri	19
 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	20
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	22
 Mbrojtja Sociale	23
QEVERISJA E MIRË	26
 Burimet Njerëzore.....	26
 Transparenca	30
 Barazia Gjinore.....	31
Integrimi në BE	33
MENAXHIMI FINANCIAR.....	35
Përfundime dhe Rekomandime	38
Rekomandime.....	38

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të vënë në pah pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të orientuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kriterëve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile, etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparençën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

Shërbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit “janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe atë publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblihen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak.

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që buxheti shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korrent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Pavarësisht nga kjo, ato mund të përdoren gjatë vitit korrent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetorë specifikë për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndër vite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. “Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara”).
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2024} - \text{Vlera 2023}) / \text{Vlera 2023} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 – Vlera 2023). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës:  = vlerë absolute ndryshimi pozitiv  = vlerë absolute ndryshimi negativ.  = nuk ka ndryshim (vlera mbetet e njëjtë)  = mungojnë të dhënat (nuk raportohen vlera për një ose të dy vitet).

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera pozitive ndryshimi = jeshile”. Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv. Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës.

Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2024 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale për vitet 2023-2024 : arsimi parauniversitar, menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja sociale, burimet njerëzore, transparenca, barazia gjinore, integrimi në BE, menaxhimi financiar. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Durrës dhe i miratuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Durrësi mbetet qendra më e rëndësishme portuale dhe turistike e Shqipërisë, si dhe qyteti i dytë më i madh në vend nga pikëpamja politike, ekonomike, administrative, edukative dhe kulturore.

Durrësi shtrihet buzë detit Adriatik, me një gjatësi bregdetare rreth 30 milje, duke u pozicionuar si një ndër zonat me zhvillimin më të shpejtë ekonomik dhe urban në Shqipëri. Bashkia Durrës shtrihet nga Kepi i Rodonit në veriperëndim deri tek Përroi i Agait pas Shkëmbit të Kavajës në jugperëndim. Ajo kufizohet me:

- Bashkinë Kurbini në veri,
- Bashkitë Krujë, Vorë dhe Shijak në lindje,
- Bashkitë Tiranë dhe Kavajë në jug e juglindje, ndërsa bregdeti perëndimor laget nga ujërat e detit Adriatik.

Relievi dhe tiparet fizike

Relievi i territorit është kryesisht fushor dhe kodrinor, me lartësinë më të madhe në Kodrën e Durrësit (178 m). Terreni bujqësor shtrihet kryesisht në fushat e Katundit të Ri, Sukthit dhe Manzës, të përshkuara nga lumi Erzen.

Në pjesën veriore dhe lindore, fushat kufizohen me vargun kodrinor të Manzës dhe Ishmit (deri në 269 m mbi nivelin e detit), që formojnë një kurrorë natyrore mbi Gjirin e Lalëzit.

Në jug, në territorin e Rrashbullit, terreni ngrihet në formacione kodrinore si Arapaj, që përbëjnë kufirin natyror të fushës së Durrësit.

Sistemi i kodrave shtrihet nga Kepi i Rodonit, në Bishtin e Pallës e deri në Kodrën e Durrësit, duke krijuar një barrierë natyrore ndaj erërave detare për qytetin dhe zonat veriore. Në verilindje të saj ndodhet fusha e Spitallës, zonë me potencial zhvillimi industrial dhe logjistik.

Struktura administrative

Bashkia Durrës është pjesë e Qarkut të Durrësit dhe përbëhet nga 6 Njësi Administrative:

1. Durrës
2. Sukth
3. Ishëm
4. Katund i Ri
5. Rrashbull
6. Manëz

Në përbërje të tyre përfshihen 40 fshatra, me një sipërfaqe totale prej 338 km². Bashkia Durrës ka sipas Gjendjes Civile 344,245 banorë ose 110,400 familje, ku 68% e popullsisë është urbane. Densiteti i popullsisë sipas të dhënave të mësipërme është 1017 banorë/km.

Administrimi dhe vizioni institucional

Bashkia Durrës drejtohet nga Kryetarja Emiriana Sako, në mandatin e saj të dytë. Vizioni i bashkisë për vitin 2024 synon konsolidimin e Durrësit si:

- një nyje e rëndësishme portuale dhe logjistike për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, energjisë dhe pasagjerëve;
- një qendër tërheqëse për investime të huaja dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm;
- një qendër urbane bashkëkohore dhe policentrike, që ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve dhe vizitorëve.

Prioritetet strategjike për vitin 2024

- *Përmirësimi i mëtejshëm i **infrastrukturës rrugore, ujësjellësve dhe kanalizimeve** në të gjitha njësitë administrative.*
- ***Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm** dhe i menaxhimi i mbetjeve, duke ofruar produkte dhe shërbime turistike sa më cilësore gjatë 365 ditëve të vitit; një qytet i pastër, më i gjelbër dhe më i sigurtë; një qytet me më shumë investime në infrastrukturë turistike për të rritur atraktivitetin si edhe për të përmirësuar aksesueshmërinë për të gjithë turistët vendas dhe të huaj.*
- ***Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale**, përfshirë kujdesin për fëmijët, të moshuarit dhe grupet në nevojë;*
- ***Investimet në infrastrukturën arsimore** që synojnë uljen e numrit të fëmijëve/nxënësve në grupe apo në klasa dhe rrjedhimisht rritjen e cilësisë së mësimdhënies.*
- ***Digjitalizimi i shërbimeve publike** dhe transparenca administrative;*

Komponenti urban i strategjisë e projekton Bashkinë Durrës si më poshtë:

- Rrashbulli si lagje e Durrësit: tashmë një fakt në terren;
- Qyteza KIS (Katund i Ri – Sukth): krijon kontinuitet urban, sinergji, ulje shpenzimesh, etj;
- Pol sub---urban Shkafane – Kullë: përgjigje ndaj zhvillimit të Shkafanës dhe pozitës gjeografike të Kullës në qendër të akseve lidhës të Bashkisë së Re;
- Këneta, si zonë mbështetëse e Zonës Industriale Porto Romano: zonë e urbanizuar për banim e shërbime mbështetëse për 30,000 të punësuarit e ZIPR;
- San Pietro / Lalëz: për turizëm cilësor;
- Kallmi si turizëm elitar dhe mushkëri e blertë e Durrësit

Komponenti turistik i strategjisë e projekton Bashkinë Durrës si më poshtë:

- Durrësi: vitrina e Shqipërisë për vizitorët e kroçierave;
- Mbrojtja dhe promovimi i parqeve natyrore / valorizimi i hinterlandit për vizitorët lokalë dhe kombëtare (nga Tirana);
- Turizmi i detit dhe i rërës: cilësore në Lalëz, Kallm dhe popullor në pjesën tjetër;
- Mbrojtja dhe valorizimi i pasurisë historike dhe arkeologjike.

Komponenti ekonomik i strategjisë e projekton Bashkinë Durrës si më poshtë:

- Thjeshtesimi i procedurave të regjistrimit të ndërmarrjeve (one---stop---shop / dixhitalizimi / etj) dhe mbulimi i gjithë territorit me to;
- kontekst fiskal avantazhues dhe logjistikë mbështetëse bashkëkohore sidomos në aksin Durana, Shkozet, ZIPR dhe PI Rrashbull;
- ngritja e Qëndrave të Mbështetjes për NVM dhe promovimin e tyre (fokusuar në shitje, marketing, netëorking, shërbime administrative / financiare, etj)
- ngritja e strukturave pritëse speciale dhe procedurave fast-track për investitorët e mëdhenj.

Toka bujqësore zë rreth 70% të territorit të Bashkisë. Komponenti bujqësor i strategjisë e projekton Bashkinë Durrës si më poshtë:

- ruajtja e fondit të tokës bujqësore nëpërmjet bllokimit të lejeve të ndërtimit dhe regjistrimit;
- rritja e eficiencës së aktiviteteve bujqësore, nëpërmjet rritjes së rendimenteve, specializimin në kultura me vlerë të lartë, kompletimi i zinxhirit të vlerës, etj;
- Krijimi i tregjeve dhe rrugëve lidhëse për inkurajimin dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës të produkteve bujqësore drejt aktiviteteve me vlerë të shtuar të lartë.

Bashkia Durrës synon të ofrojë shërbime efikase, cilësore dhe gjithëpërfshirëse, të orientuara drejt qytetarëve dhe nevojave të tyre. Qëllimi kryesor është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së banorëve, si dhe reduktimi i pabarazive sociale dhe ekonomike, si brenda

territorit të Bashkisë, ashtu edhe në raport me bashkitë dhe rajonet e tjera të ngjashme në Ballkan dhe Evropën Juglindore.

Bashkia Durrës angazhohet të ofrojë për komunitetin e saj:

- një jetë me standarde të larta dhe mjedis të qëndrueshëm;
- mundësi të barabarta për arsimim cilësor dhe zhvillim profesional;
- orientim drejt punësimit të qëndrueshëm dhe të kënaqshëm;
- akses të lehtë dhe të shpejtë në shërbimet administrative vendore;
- pjesëmarrje aktive të qytetarëve në hartimin e politikave zhvillimore;
- lehtësim të lëvizshmërisë lokale dhe rajonale;
- si dhe përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës rrugore, portuale, hekurudhore dhe ujore.

Viti 2024 ka shënuar një periudhë stabilizimi dhe rritjeje të qëndrueshme ekonomike, pas përfundimit të shumicës së projekteve të rindërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës bazë. Sektori i turizmit ka njohur një rritje të konsiderueshme të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj. Në zonat rurale, janë mbështetur iniciativa që nxisin zhvillimin e bujqësisë, agroturizmit dhe investimet në infrastrukturën rrugore, duke kontribuar në forcimin e ekonomisë lokale dhe shtimin e mundësive për punësim.

Bashkia Durrës udhëhiqet nga parimi i balancimit të rritjes ekonomike me cilësinë e jetës, duke integruar aspektet sociale dhe mjedisore në politikat e zhvillimit vendor. Synimi mbetet zhvillimi i qëndrueshëm dhe i integruar i qytetit dhe gjithë territorit të bashkisë, në funksion të një mjedisi të pastër, infrastrukture funksionale dhe shërbimesh efektive për çdo komunitet.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2024
Popullsia totale në administrimin e bashkisë	344'245
Popullsia në qytet	235'322
Popullsia në njësitë administrative	108'923
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	341.9
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	
Sipërfaqja e njësive administrative në total	
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	5566
Sipërfaqe totale e fondit kullësor (në ha)	614
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	15129.73
Numri total i njësive administrative të bashkisë	11
Numri i fshatrave	40
Punonjës të bashkisë në total	1920
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	1017
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	903
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	455
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	268

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësi të saj sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Në këtë seksion, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performances bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (duke përfshirë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendorë që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë arritjet, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”
- Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre.

Në këtë seksion janë monitoruar 5 tregues kryesorë dhe 12 nën-tregues, të cilët mbulojnë qasjen në arsim (regjistrimin në çerdhe dhe kopshte publike e private), cilësinë e shërbimit (raportin fëmijë–mësues) si dhe gjendjen e infrastrukturës arsimore.

Në vitin 2024 u vu re një përmirësim i ndjeshëm në shumicën e treguesve dhe nëntreguesve të sektorit të arsimit, krahasuar me vitin 2023, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor.

Nga pesë treguesit kryesorë të monitoruar, tre kanë shënuar rritje pozitive, njëri ka mbetur i pandryshuar, ndërsa një tregues ka shënuar përkeqësim të lehtë. Ky i fundit lidhet me raportin fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private. Është e rëndësishme të theksohet se për vitin 2023 mungonin të dhënat për kopshtet private, çka e bën të pamundur krahasimin e plotë të këtij treguesi për të dy sektorët. Megjithatë, në kopshtet publike ky raport ka përmirësim prej rreth 3%, duke reflektuar optimizimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e shpërndarjes së fëmijëve në grupet mësimore.

Në veçanti, shkalla e regjistrimit në çerdhe publike u rrit nga 6.00% në 9.48%, duke reflektuar një përmirësim prej 58%, ndërsa shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private u rrit nga 38.16% në 46.25%, me një ndryshim pozitiv prej 8.09 pikë përqindje ose 21%. Numri i godinave arsimore u rrit lehtë nga 161 në 163, me një përmirësim prej 1%. Bashkia ka miratuar Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar në Shtator të vitit 2025.

Ndërsa nëntreguesi që lidhet me godinat arsimore publike për shkollat 9-vjeçare ka shënuar një përkeqësim të lehtë gjatë vitit 2024. Ky ndryshim lidhet me mbylljen e Shkollës 9-vjeçare “Adem Gjeli” në Njësinë Administrative Ishëm, si rezultat i numrit shumë të vogël të nxënësve që frekuentonin këtë institucion. Nxënësit e kësaj shkolle janë transferuar në shkollat më të afërta, duke siguruar vijimësinë e procesit mësimor pa ndërprerje dhe në kushte të përshtatshme.

Pas tërmetit të vitit 2019, Bashkia Durrës ka ndërmarrë një proces të gjerë rindërtimi dhe rehabilitimi të infrastrukturës arsimore në të gjitha nivelet e sistemit publik arsimor. Gjatë viteve pasuese janë realizuar ndërhyrje të thella në shkolla dhe kopshte që kishin pësuar dëmtime strukturore, duke garantuar kushte të sigurta dhe bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor-edukativ.

Aktualisht, të gjitha objektet arsimore në territorin e Bashkisë Durrës janë ndërtuar ose rikonstruktuar plotësisht, ndërsa vetëm një numër i kufizuar prej tyre ndodhen në fazat përfundimtare të punimeve. Falë këtyre investimeve, është arritur një rritje e dukshme e indikatorëve të cilësisë së shërbimeve arsimore, përfshirë:

- përmirësimin e kushteve mësimore dhe higjieno-sanitare;
- rritjen e sigurisë strukturore të ndërtesave;
- krijimin e mjediseve të përshtatshme për aktivitete jashtëkurrikulare;
- përfshirjen e teknologjisë bashkëkohore në mësimdhënie.

Këto ndërhyrje kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin institucionet publike arsimore, si dhe në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit prindëror dhe stafit arsimor.

Treguesit përmbledhës

Lloj	Totali	Të dy vitet	Jeshile	Portokalli	E kuqe	Gri	Performuesi më i mirë	Performuesi më i dobët
Tregues	5	5	3	1	1	0	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private ($\Delta=8.0896788411195146$)	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private ($\Delta=-\infty$)
Nen-tregues	12	12	9	0	3	0	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte private ($\Delta=41500$)	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte publike ($\Delta=-1400$)

Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	6.00	9.48	3.49	↑	Përmirësuar	🟢	58%
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	38.16	46.25	8.09	↑	Përmirësuar	🟢	21%
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟡	
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	161.00	163.00	2.00	↑	Përmirësuar	🟢	1%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike	%	28200.00	28600.00	400.00	↑	Përmirësuar	🟢	1%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në çerdhe publike	%	28700.00	32000.00	3300.00	↑	Përmirësuar	🟢	11%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në kopshte publike	%	158400.00	164800.00	6400.00	↑	Përmirësuar	🟢	4%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte publike	%	176600.00	175200.00	-1400.00	↓	Përkeqësuar	🔴	-1%
Nen-tregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	118.00	117.00	-1.00	↓	Përkeqësuar	🔴	-1%
Nen-tregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	44.00	47.00	3.00	↑	Përmirësuar	🟢	7%

🗑️ MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e

pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Analiza e të dhënave për Menaxhimin e Mbetjeve paraqet një situatë kryesisht të qëndrueshme midis viteve 2023 dhe 2024, me disa përmirësime të kufizuara dhe pak ndryshime domethënëse në treguesit kryesorë. Në total janë analizuar 4 tregues dhe 2 nëntregues, ku vetëm një tregues ka shënuar përmirësim, një tjetër është përkeqësuar lehtë, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur e pandryshuar. Kjo tregon një stabilitet në sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

Treguesi i parë, “Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale”, mbeti i pandryshuar në 100% për të dy vitet, çka tregon se të gjithë banorët në zonat urbane dhe rurale vazhdojnë të jenë të mbuluar me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Po ashtu, nëntreguesit që ndajnë këtë tregues sipas zonave tregojnë stabilitet të plotë, me vlerë 100% në urban dhe 100% në rural, pa ndryshim në mbulim apo shtrirje gjeografike.

Treguesi “Mbetjet e gjeneruara si kg/banor” u ul lehtë nga 196.51 kg/banor në vitin 2023 në 196.27 kg/banor në vitin 2024, me një ndryshim shumë të vogël prej -0.24 kg/banor, që përfaqëson një ulje pothuajse të papërfillshme (0%). Edhe pse kjo llogaritet si ulje, në realitet ndryshimi është minimal dhe tregon një stabilitet të nivelit të mbetjeve të prodhuara për frymë gjatë periudhës së raportimit.


Në anën tjetër, “Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit” shënoi përmirësim të dukshëm, duke u rritur nga 0.25% në 0.39%, me një ndryshim pozitiv prej 56%. Ky tregues tregon se bashkia ka përmirësuar efikasitetin financiar të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, duke mbledhur më shumë të ardhura nga tarifat e qytetarëve për të mbuluar koston reale të operimit. Megjithatë, niveli mbetet ende shumë i ulët, çka sinjalizon nevojën për rishikim të politikave tarifore dhe përmirësim të mekanizmave të arkëtimit për të arritur qëndrueshmëri financiare.

Shpenzimet për programin e menaxhimit të mbetjeve janë 932’478’000 lekë, të ardhurat e bashkisë nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve (familjet dhe bizneset) janë 364’311’112 lekë dhe mbulojnë 39% të shpenzimeve të programit për menaxhimin e mbetjeve, 26% financohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet transfertës sektoriale për depozitim

mbetjeve në Sharrë me vlerë 240'791'083 lekë dhe 35% e shpenzimeve mbulohen nga buxheti i bashkisë për mbetjet (pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve) me vlerë 327'375'805 lekë.

Bashkia ka përmbushur kërkesën ligjore për planifikimin afatmesëm të menaxhimit të mbetjeve duke miratuar dhe zbatuar Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, i cili siguron bazën strategjike për masat e menaxhimit, monitorimit dhe përmirësimit të shërbimeve.

Në përmbledhje, viti 2024 tregon një gjendje të stabilizuar të menaxhimit të mbetjeve, me mbulim të plotë të popullsisë, nivel konstant të mbetjeve të gjeneruara për frymë, dhe rritje modeste në mbulimin financiar të kostove të shërbimit. Megjithatë, mungesa e përmirësimeve në treguesit strukturorë dhe planifikues tregon nevojën për masa më të forta në drejtim të qëndrueshmërisë financiare, reduktimit të mbetjeve dhe përfshirjes së praktikave të riciklimit, në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen.



Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	196.51	196.27	-0.24	↓	Përkeqësuar	I	0%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	0.25	0.39	0.14	↑	Përmirësuar	I	56%
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	1.00	100.00	→	Pa ndryshim	I	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	100.00	1.00	0100.00	→	Pa ndryshim	I	0%

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	11.00	11.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	11.00	11.00	Numër
Numri fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	40.00	40.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkisë	40.00	40.00	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	67094000.00	67564700.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	241469.00	364311.00	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	965717.00	932487.00	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	341425.00	344245.00	Numër


Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë : Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Raporti përmbledhës për Mbrojtjen nga Zjarri tregon një përmirësim të dukshëm në kapacitetet njerëzore dhe teknike të shërbimit zjarrëfikës nga viti 2023 në 2024, duke reflektuar një forcim të mekanizmave të reagimit dhe gatishmërisë operacionale në nivel bashkie. Të dy treguesit e vlerësuar kanë shënuar rritje pozitive, pa asnjë përkeqësim apo stagnim, çka e bën këtë sektor një nga më performuesit në raportet institucionale për periudhën e analizuar.

Treguesi i parë, “Zjarrëfikës për 1,500 banorë”, është rritur nga 0.18 në vitin 2023 në 0.20 në vitin 2024, me një rritje absolute prej 0.03 njësi ose 17% në përqindje. Ky ndryshim pozitiv tregon një rritje të numrit të efektivëve zjarrëfikës në raport me popullsinë, duke përmirësuar ndjeshëm përgjigjen operacionale ndaj emergjencave dhe sigurinë publike.

Në të njëjtën linjë, treguesi “Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë” është rritur nga 0.21 në 0.23, me një ndryshim pozitiv prej 0.03 njësi ose 13% rritje. Kjo tregon përmirësim në infrastrukturën logjistike dhe teknike të shërbimit zjarrëfikës, përmes shtimit të mjeteve zjarrëfikëse, përmirësimit të kushteve të funksionimit të flotës ekzistuese, ose rinovimit të automjeteve të vjetra me mjete më efikase. Ky përmirësim rrit aftësinë e reagimit në kohë dhe përballimin e ngjarjeve me rrezik të lartë, veçanërisht gjatë periudhave të nxehta dhe të thata kur rreziku i zjarreve pyjore dhe urbane është më i lartë.

Në përmbledhje, të dy treguesit tregojnë një trend përmirësues të qartë, me rritje të numrit të zjarrëfikësve dhe të automjeteve për frymë, duke përforcuar sigurinë komunitare dhe efikasitetin në menaxhimin e emergjencave. Performuesi më i mirë i këtij raporti është treguesi për numrin e zjarrëfikësve për 1,500 banorë, me një rritje më të lartë relative (+17%), ndërsa treguesi për automjetet zjarrëfikëse mbetet gjithashtu pozitiv me rritje +13%. Ky progres reflekton angazhimin institucional për forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes nga zjarri, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e efikasitetit të reagimit ndaj emergjencave lokale.



Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.18	0.20	0.03	↑	Përmirësuar	■	17%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.21	0.23	0.03	↑	Përmirësuar	■	13%

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	40.00	47.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	341425.00	344245.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	7.00	8.00	Numër



MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT


Përshkrim i përgjithshëm: Funkcioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Raporti përmbledhës për Ujitjen dhe Kullimin tregon një përmirësim të dukshëm në funksionalitetin e infrastrukturës ujitëse dhe kulluese nga viti 2023 në 2024, ndonëse pa ndryshime në sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore të pajisur me kanale. Në total, u analizuan dy tregues kryesorë dhe dy nëntregues, ku të gjithë përveç njërit shënuan progres të qartë në performancë.

Treguesi “Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi” mbeti i pandryshuar në 11.75% për të dy vitet, duke treguar se nuk ka pasur zgjerim të sipërfaqes së mbuluar me rrjete ujitjeje apo kullimi. Kjo përputhet me të dhënat burimore, sipas të cilave sipërfaqja totale e tokës bujqësore dhe ajo e pajisur me kanale kanë mbetur konstante — përkatësisht 15,129.73 hektarë dhe 1,778 hektarë. Në të kundërt, treguesi i dytë, “Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale”, është përmirësuar ndjeshëm nga 28.58% në 34.39%, me një rritje prej 5.81 pikë përqindje ose 20%. Kjo tregon një progres real në mirëmbajtjen dhe rikthimin në funksion të rrjeteve ekzistuese, duke rritur efikasitetin e sistemit pa pasur nevojë për zgjerime të reja infrastrukturore.

Në nivel nëntreguesish, të dy treguesit kanë pasur prirje pozitive. “Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale” u rrit nga 21.88% në 29.38%, që përkthehet në një përmirësim prej 7.5 pikë përqindje ose 34%. Ky ndryshim lidhet drejtpërdrejt me rritjen e gjatësisë së kanaleve ujitëse funksionale nga 35 km në 47 km, ndërkohë që gjatësia totale e kanaleve ujitëse mbeti e pandryshuar në 160 km. Po kështu, “Përqindja e kanaleve kulluese funksionale” u përmirësua nga 35.29% në 39.41%, një rritje prej 4.12 pikë përqindje ose 12%, që reflekton shtimin e kanaleve funksionale nga 60 km në 67 km, ndërkohë që rrjeti total i kanaleve kulluese mbeti 170 km.

Në përmbledhje, viti 2024 solli rritje të funksionalitetit të rrjeteve të ujitjes dhe kullimit pa ndryshime në përmasat fizike të tyre apo në sipërfaqet bujqësore të përfshira. Kjo tregon një fokus më të madh në mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës ekzistuese, duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetin funksional të sistemit të ujitjes dhe kullimit në nivel vendor, pa shtim të investimeve të reja në zgjerim territorial.



Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	11.75	11.75	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	28.58	34.39	5.81	↑	Përmirësuar	I	20%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	21.88	29.38	7.50	↑	Përmirësuar	I	34%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	35.29	39.41	4.12	↑	Përmirësuar	I	12%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	15129.73	15129.73	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	1778.00	1778.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	160.00	160.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	35.00	47.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	170.00	170.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	60.00	67.00	Kilometër (km)

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funkcioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Raporti përmbledhës për Pyje dhe Kullota tregon një situatë të qëndrueshme midis viteve 2023 dhe 2024, pa asnjë ndryshim në vlerat e treguesve apo nëntreguesve të raportuar. Në total janë analizuar 3 tregues kryesorë, të cilët të tre kanë ruajtur të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar mungesë progresi në drejtim të planifikimit, menaxhimit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në administrimin e burimeve pyjore dhe kullotave.

Plani Vendor i Mbarështimit nuk është miratuar gjatë periudhës së raportimit. Kjo tregon një mungesë të qartë në planifikimin afatmesëm të përdorimit dhe ruajtjes së pyjeve dhe kullotave, e cila ndikon në qëndrueshmërinë e burimeve natyrore dhe në zbatimin e standardeve të mirëmenaxhimit. Edhe treguesi i tretë, “Punonjës për 1,000 hektarë”, ka mbetur konstant në 0.48 punonjës për 1,000 ha për të dy vitet, pa asnjë ndryshim në strukturën e stafit apo forcimin e kapaciteteve njerëzore në fushën e administrimit të pyjeve dhe kullotave. Kjo tregon se niveli i burimeve njerëzore ka mbajtur të njëjtën normë të ngarkesës së punës për punonjësit ekzistues.

Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/1000 ha	0.48	0.48	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	0.00	0.00	Cilësore (Po/Jo)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullor në bashki	6205.00	6205.00	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullor e mbuluar me plan mbarështimi	0.00	0.00	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor	3.00	3.00	Numër

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për

riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me organizata jo fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Raporti përmbledhës për Mbrojtjen Sociale tregon një dinamikë ndryshimesh midis viteve 2023 dhe 2024, me disa përmirësime të ndjeshme në përfshirjen e familjeve dhe aksesin në shërbime sociale, por edhe rënie të theksuar në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Në total janë analizuar 6 tregues dhe 11 nëntregues, ku 4 tregues dhe disa nëntregues u përmirësuan, ndërsa të tjerët pësuan përkeqësim ose mbetën të pandryshuar.

Treguesi më pozitiv ishte “Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike”, e cila u rrit ndjeshëm nga 54.30% në vitin 2023 në 76.52% në vitin 2024, me një ndryshim pozitiv prej 22.23 pikë përqindje ose 41%, duke reflektuar zgjerim të aksesit në programet e ndihmës ekonomike. Ky përmirësim tregon se bashkia ka rritur kapacitetin për të identifikuar dhe mbështetur familjet në nevojë. Po ashtu, “Shkalla e miratimit të strehimit social” u rrit nga 10.58% në 11.75%, një rritje prej 11%, që tregon përmirësim në miratimin e kërkesave për strehim social dhe një fokus më të lartë ndaj politikave sociale për grupet vulnerabël.


Një tjetër tregues që u përmirësua ishte “Përqindja e rasteve të referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) që përfitojnë shërbime sociale”, e cila u rrit nga 28.19% në 36.20%, me një rritje prej 8.01 pikë përqindje (28%), duke treguar se bashkia ka arritur të ofrojë mbështetje më efektive për rastet që identifikohen nga strukturat e koordinimit ndërinstytucional. Brenda këtij treguesi, nëntreguesi për femrat e referuara nga MKR që përfitojnë shërbime sociale u rrit me 8% (nga 0.35% në 0.38%), ndërsa për meshkujt nuk pati asnjë ndryshim, duke mbetur në 0.00%. Kjo sugjeron një fokus të vazhdueshëm tek mbështetja e grave në nevojë duke qënë se është dhe nr më i madh i rasteve të dhunës në familje.

Treguesi “Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara” ka pësuar një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2024, duke zbritur nga 92.22% në 20.55%, që përfaqëson një ulje prej 71.68 pikë përqindje ose rreth -78%. Ky tregues rezulton të jetë performuesi më i dobët në fushën e mbrojtjes sociale për këtë vit por kjo lidhet me ndryshime në metodologjinë e vlerësimit të përfituesve, pasi pas referimit nga strukturat sociale, çdo rast kalon për shqyrtim në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i cili vendos nëse personi përfiton ose jo mbështetje financiare apo shërbime të integruara. Kjo do të thotë se jo të gjithë personat e referuar përfshihen në skemat e ndihmës, pasi përfitimi kushtëzohet nga vendimi përfundimtar i komisionit. Disagregimi i treguesit sipas gjinisë dhe moshës tregon për një përkeqësim të ndjeshëm në të gjitha grupet:

- Gratë me aftësi të kufizuar që marrin mbështetje përbëjnë vetëm 0.20%,
- Burrat përfaqësojnë 0.22%,
- Ndërsa sipas moshës: grupmosha 0–17 vjeç përfshin 0.42%, dhe grupmosha 18+ vetëm 0.11%.

Nga ana tjetër, treguesi “Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licencuara për 10,000 banorë” mbeti praktikisht i pandryshuar, me vlerë 0.29 në të dy vitet, por u kategorizua si përkeqësim i lehtë (-1%), për shkak të mungesës së zgjerimit të rrjetit të qendrave sociale.

Në përmbledhje, viti 2024 shënoi progres të dukshëm në aksesin në ndihmë ekonomike dhe strehim social, si dhe rritje të efikasitetit të mekanizmit të referimit për shërbime sociale, ndërsa sfidat më të mëdha mbeten tek mbështetja për personat me aftësi të kufizuara dhe zgjerimi i infrastrukturës së qendrave sociale. Performanca e përgjithshme sugjeron një përmirësim të targetimit të përfituesve dhe funksionimit institucional, por kërkon fokus më të madh në barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në politikat e ardhshme të mirëqenies sociale.



E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	547.00	345.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	297.00	264.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	341425.00	344425.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	1749.00	3047.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	185.00	358.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	7.00	7.00	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	3.00	3.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	227.00	221.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	64.00	80.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	3612.00	2604.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	3331.00	535.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore(Po=1/Jo=0)

Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	54.30	76.52	22.23	↑	Përmirësuar		41%
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	10.58	11.75	1.17	↑	Përmirësuar		11%
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banorë	0.29	0.29	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	28.19	36.20	8.01	↑	Përmirësuar		28%
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	92.22	20.55	-71.68	↓	Përkeqësuar		41%
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	0.35	0.38	0.03	↑	Përmirësuar		8%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		

QEVERISJA E MIRE

BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit, përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Raporti përmbledhës për Burimet Njerëzore tregon zhvillime të rëndësishme midis viteve 2023 dhe 2024, me përmirësime të dukshme në trajnimin e stafit dhe shtimin e numrit të punonjësve për banor, por gjithashtu me disa tregues që sinjalizojnë përkeqësim, veçanërisht në fushën e rotacionit të punonjësve.

Treguesi “Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë” është rritur nga 11.75% në 12.24%, një rritje prej 40%, që tregon një stabilitet relativ. Kjo rritje lidhet me rritjen e numrit absolut të punonjësve gjatë vitit të raportimit, ku stafi total u rrit ndjeshëm nga 1,856 në 1,920 persona, ndërkohë që numri i punonjësve të larguar u rrit lehtë nga 218 në 235. Ky kombinim sugjeron rritje të kapaciteteve, por me sfida në ruajtjen e qëndrueshmërisë së stafit.

Nga ana tjetër, treguesi “Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar” shënoi rritje të fortë nga 13.28% në 18.77%, me një ndryshim pozitiv prej 5.48 pikë përqindje ose 41%, duke e bërë atë performuesin më të mirë në këtë grup. Numri i punonjësve të trajnuar u dyfishua nga 163 në 353, çka tregon një investim të dukshëm në zhvillimin profesional të stafit, veçanërisht në një kontekst të rritjes së përgjithshme të punësimit.

Një tjetër tregues i përmirësuar është “Punonjës për 1,000 banorë”, i cili u rrit nga 5.53 në 5.67, një rritje prej 3%, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të kapacitetit njerëzor të bashkisë në raport me popullsinë, e cila vetë u rrit lehtë nga 341,425 në 344,245 banorë.

Në nivel nëntreguesish, rezultatet janë të përziera.

- Stafi femër ka pasur rritje të rotacionit (nga 8.17% në 10.68%), çka sugjeron largime më të shpeshta tek gratë në 2024.
- Stafi mashkull ka pësuar ulje të lehtë (nga 14.29% në 13.41%), duke sinjalizuar më pak lëvizje në këtë kategori.
- Administrata qendrore ka shënuar një përmirësim të dukshëm të stabilitetit, me rotacion që ka rënë nga 6.11% në 5.49%.
- Njësitë shpenzuese kanë rritje të rotacionit (nga 13.51% në 14.33%), duke reflektuar dinamikë më të lartë lëvizjesh në terren.

Për sa i përket trajnimeve të stafit, një nga ndryshimet më të theksuara të vitit 2024 lidhet me rritjen e ndjeshme të numrit të punonjësve të trajnuar. Nga 163 punonjës të trajnuar në vitin 2023, numri është rritur në 353, duke sjellë një rritje 117%.



Kjo reflektohet edhe te treguesit përkatës:

- Përqindja e stafit të trajnuar është dyfishuar (nga 8.78% në 18.39%).
- Stafi femër i trajnuar është rritur me 95%.
- Stafi mashkull i trajnuar me 119%.
- Njësitë shpenzuese kanë përjetuar një rritje shumë të fortë të trajnimeve (nga 7.71% në 21.09%).

- E vetmja kategori me ulje është administrata, ku përqindja e stafit të trajnuar ka rënë nga 12.22% në 9.67%.

Të tre treguesit kryesorë të performancës – rotacioni, përqindja e stafit të trajnuar dhe punonjësit për 1000 banorë – janë kategorizuar si të përmirësuar. Kjo tregon një tendencë pozitive në menaxhimin e burimeve njerëzore në nivel strukture. Ndërsa te nën-treguesit ka një kombinim përmirësimesh dhe përkeqësimesh, panorama e përgjithshme mbetet pozitive: pesë nën-tregues janë përmirësuar dhe tre janë përkeqësuar.

Në përmbljedhje, viti 2024 shënoi një rritje të numrit të punonjësve dhe të trajnimeve, si dhe përmirësim në aftësimin profesional, por gjithashtu u evidentuan sfida në stabilitetin e stafit dhe barazinë gjinore në pjesëmarrjen në trajnime. Përmirësimet në kapacitetet njerëzore dhe aftësitë teknike përbëjnë një bazë të fortë për efikasitet më të lartë institucional, ndërsa dobësitë në rotacionin e stafit kërkojnë politika më të qëndrueshme për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve në administratën bashkiake.



Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	11.75	12.24	0.49	↑			4%
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	8.78	18.39	9.60	↑	Përmirësuar	●	109%
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjës/1,000 banorë	5.53	5.67	0.14	↑	Përmirësuar	●	3%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	8.17	10.68	2.51	↑			31%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	14.29	13.41	-0.87	↓			-6%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	6.11	5.49	-0.61	↓			-10%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	13.51	14.33	0.83	↑			6%
Nen-tregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	7.78	15.17	7.39	↑	Përmirësuar	●	95%
Nen-tregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	9.49	20.80	11.31	↑	Përmirësuar	●	119%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	12.22	9.67	-2.55	↓	Përkeqësuar	●	-21%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	7.71	21.09	13.38	↑	Përmirësuar	●	174%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	1856.00	1920.00	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	218.00	235.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	341425.00	344245.00	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	163.00	353.00	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	32.00	32.00	Numër

Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkia ka detyrimin të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japi llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin. Në këtë kuadër, bashkia duhet të garantojë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

Të dhënat tregojnë një qasje pozitive të bashkisë ndaj konsultimit publik dhe transparencës, duke reflektuar përpjekje të qëndrueshme për të institucionalizuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Në vitin 2023 janë zhvilluar 3 konsultime 3 aktet që kërkonin detyrimisht këtë proces, çka tregon një angazhim të plotë për respektimin e standardeve ligjore dhe përfshirjen e publikut. Ndërkohë që në vitin 2024 numri i akteve të konsultuara është 4, një vlerë më e ulët në raport me totalin prej 6 aktesh, 2 akte kanë të bëjnë me shpronësimet të cilat janë bërë në lidhje me projektet e qeverisë dhe degjesat janë bërë nga Ministria e Kulturës. Në aspekt teknik, fakti që bashkia vazhdon të publikojë Raportin Vjetor të Transparencës dhe mban në fuqi Planin Vendor të Integritetit dëshmon se ka struktura funksionale dhe mekanizma të konsoliduar të qeverisjes së mirë, mbi të cilat mund të ndërtohet forcimi i mëtejshëm i praktikave të konsultimit dhe llogaridhënies.

Për të avancuar në këtë drejtim, nevojitet rivendosje e mekanizmave të konsultimit publik, rritje e komunikimit me komunitetin dhe përmirësim i zbatimit të planeve ekzistuese të integritetit dhe transparencës, në mënyrë që të sigurohet një qeverisje vendore më gjithëpërfshirëse dhe e hapur ndaj qytetarëve.

Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Akte për të cilët është detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	punonjës/1500 banorë	100.00	66.67	-33.33	↓	Përkeqësuar	I	-33%
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	mjete/10000 banorë	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%
Tregues	Plani Vendor i Integritetit		1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	I	0%

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	3.00	6.00	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	3.00	4.00	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)

BARAZIA GJINORE


Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integritimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në përputhje me legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore, në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjegjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione vendimmarrëse, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Raporti përmbledhës mbi Barazinë Gjinore tregon një panoramë të përzier të ndryshimeve nga viti 2023 në vitin 2024, me disa përmirësime domethënëse në përfaqësimin e grave në strukturat vendimmarrëse, por edhe një rënie të ndjeshme në nivelin e drejtimit të brendshëm në bashki. Në total, u analizuan tre tregues kryesorë, prej të cilëve një u përmirësua, një u përkeqësua, dhe një mbeti i pandryshuar.

Treguesi i parë, “Përqindja e grave në pozicione si kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore”, shënoi rritje të ndjeshme nga 28.89% në vitin 2023 në 38.81% në vitin 2024, duke reflektuar një përmirësim prej 9.92 pikë përqindje ose 34%. Ky ndryshim pozitiv tregon se gratë fituan më shumë hapësirë në pozicionet publike dhe përfaqësuese, duke arritur një balancë më të mirë gjinore në strukturat vendore.

Hartimi dhe zbatimi i “Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore” për të dy vitet tregon se bashkia ka ngritur një mekanizëm të strukturuar strategjik për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në aspekt teknik, kjo tregon se institucioni ka të përcaktuara objektiva, masa dhe indikatorë monitorimi, të cilat mundësojnë vlerësimin e progresit dhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në politikat lokale dhe në shërbimet publike.

Në përmbledhje, viti 2024 shënoi një përmirësim në përfaqësimin politik të grave, por një rënie të dukshme në drejtimin institucional, duke treguar nevojën për politika më të qëndrueshme dhe masa të balancuara që sigurojnë jo vetëm pjesëmarrje, por edhe qëndrueshmëri të grave në pozicione vendimmarrëse në të gjitha nivelet e administratës vendore.



Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	28.89	38.81	9.92	↑	Përmirësuar	■	34%
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	71.43	33.87	-37.56	↓	Përkeqësuar	■	-53%
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	■	0%

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	90.00	67.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	26.00	26.00	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	56.00	62.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	40.00	21.00	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo).

INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, edhe qeverisjen vendore. Bashkitë luajnë një rol kritik në përafrimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomadohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Raporti përmbledhës për Integrimin në Bashkimin Evropian tregon një situatë kryesisht të qëndrueshme midis viteve 2023 dhe 2024, me vetëm një tregues që ka pësuar përmirësim, ndërsa të tjerët kanë mbetur të pandryshuar. Nga pesë treguesit e analizuar, katër shënuan status

të qëndrueshëm (pa ndryshim), dhe një tregues – Komisionet e Integritetit Evropian pranë këshillave bashkiakë – shënoi progres, duke u bërë performuesi më i mirë i këtij raporti.

Treguesi “Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë” u përmirësua nga 0.00 në 1.00, duke reflektuar krijimin dhe funksionalizimin e strukturave të posaçme që merren me çështjet e integritetit në nivel vendor gjatë vitit 2024. Ky ndryshim është i rëndësishëm pasi tregon një hap konkret drejt institucionalizimit të procesit të integritetit evropian në bashki, përmes përfshirjes së organeve përfaqësuese lokale në monitorim dhe bashkërendim të politikave. Në të kundërt, treguesi “Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki” mbeti 0.00 për të dy vitet, duke treguar mungesë të bashkëpunimeve formale ndërmjet bashkive në fushën e integritetit, dhe duke u renditur si performuesi më i dobët në këtë grup. Edhe pse ky tregues nuk tregon përkeqësim, ai sinjalizon një mungesë të dinamizmit në partneritetet ndërvendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë thelbësore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore.

Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki, i reflektuar me vlerën 1.00, tregon se institucioni ka vendosur një arkitekturë të brendshme menaxheriale për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve. Bashkia nuk ka ende një dokument strategjik si “Plani i migracionit dhe diasporës” të miratuar, çka nga këndvështrimi teknik nënkupton mungesën e një kornize të strukturuar për menaxhimin e migracionit, bashkëpunimin me diasporën dhe shfrytëzimin e potencialeve të saj zhvillimore. Kjo gjithashtu sugjeron se proceset e mbledhjes së të dhënave, analizës demografike dhe planifikimit të masave të orientuara për komunitetet migrante nuk janë të formalizuara, duke lënë hapësirë për përmirësim në hartimin e politikave të bazuara në evidencë. Po kështu, treguesi “Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga Bashkimi Evropian (periudha 2-vjeçare)” mbeti konstant në 26.67%, duke treguar stabilitet, por edhe mungesë të rritjes së kapacitetit për të fituar projekte të reja me financim evropian.

Në përmbledhje, viti 2024 karakterizohet nga ruajtje e status quo-së institucionale, me një përmirësim të vetëm në krijimin e Komisioneve të Integritetit Evropian në këshillat bashkiakë, që përfaqëson një hap pozitiv në forcimin e strukturave vendore për integritetin në BE. Megjithatë, mungesa e progresit në marrëveshjet ndërbashkiake, projektet e reja dhe planet e diasporës tregon nevojën për aktivizim më të madh institucional dhe ndërbashkiak, në mënyrë që bashkia të forcojë rolin e saj në procesin e integritetit evropian dhe të rrisë ndikimin përmes projekteve dhe bashkëpunimeve konkrete.

Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	26.67	26.67	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		
Tregues	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar		

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	0.00	0.00	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritetit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	0.00	0.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	15.00	15.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	4.00	4.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	0.00	1.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxheti. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të

bashkive dhe në analizën e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Raporti përmbledhës për tregon një përmirësim të përgjithshëm të situatës financiare të bashkisë nga viti 2023 në 2024, me rritje të të ardhurave vetjake, të buxhetit për frymë dhe të strukturës së të ardhurave vendore, megjithëse disa tregues që lidhen me investimet dhe ekzekutimin buxhetor kanë shënuar rënie. Nga 12 tregues të analizuar, 7 janë përmirësuar, ndërsa 5 janë përkeqësuar, duke dhënë një tablo të balancuar mes përparimit fiskal dhe sfidave në menaxhimin e shpenzimeve dhe investimeve.


Treguesi “Të ardhurat e veta për frymë” u rrit nga 6,914.81 lekë/person në 2023 në 8,505.05 lekë/person në 2024, me një rritje prej 23%, që reflekton rritjen e të ardhurave vendore faktike nga 2,360,890 mijë lekë në 2,927,822 mijë lekë. Në të njëjtën kohë, transfertat nga qeveria qendrore u rritën nga 2,051,438 mijë lekë në 2,393,134 mijë lekë, por raporti midis të ardhurave vetjake dhe transfertave u përmirësua me 7.26 pikë përqindje (nga 115.08% në 122.34%), duke treguar një varësi më të ulët nga transfertat dhe autonomi më të madhe fiskale. Po ashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit u rrit lehtë nga 53.51% në 55.02%, duke sinjalizuar një rritje të peshës së burimeve të brendshme në financimin e shpenzimeve bashkiake.

Ndër treguesit me përmirësim, “Buxheti i miratuar për frymë” pati një rritje të konsiderueshme nga 13,706.52 lekë/person në 15,488.27 lekë/person, me një ndryshim pozitiv prej 13%, duke e bërë atë performuesin më të mirë të këtij raporti. Po ashtu, “Të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore” u rritën nga 14.04% në 17.60% (+25%), si pasojë e rritjes së të ardhurave faktike nga kjo taksë prej 331,375 mijë lekë në 2023 në 515,238 mijë lekë në 2024, duke treguar një efikasitet më të lartë në mbledhjen e taksave vendore.

Në anën tjetër, disa tregues financiarë kyç kanë shënuar rënie. “Shkalla e përdorimit të të ardhurave” ra nga 80.39% në 71.92% (-8.47 pp, -11%), duke treguar se një pjesë më e madhe e të ardhurave të planifikuara nuk është shpenzuar, çka mund të lidhet me mosrealizimin e projekteve ose zvarritje në proceset buxhetore. Po ashtu, “Shkalla e ekzekutimit të buxhetit” u ul nga 75.80% në 71.77% (-5%), dhe “Pesha e investimeve në buxhet” ra nga 23.75% në 20.21% (-15%), duke reflektuar shkurtimin e investimeve kapitale, të cilat u reduktuan nga 842,569 mijë lekë në 773,398 mijë lekë. Kjo rënie shfaqet edhe te treguesi “Investime për frymë”, që ra nga 2,467.80 lekë/person në 2,246.65 lekë/person (-9%), duke e renditur si performuesin më të dobët të raportit.

Megjithatë, bashkia ka bërë përmirësime domethënëse në menaxhimin financiar: detyrimet e papaguara ndaj të tretëve janë ulur ndjeshëm nga 309,510 mijë lekë në 39,606 mijë lekë, që përkethehet në një rënie prej -7.69 pikë përqindje ose -88%, duke reduktuar ndjeshëm barrën e borxheve afatshkurtra. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e personelit janë rritur me 4% (nga 41.43% në 42.90% të buxhetit), ndërsa shpenzimet operacionale me 6% (nga 34.81% në 36.89%), duke sinjalizuar rritje të peshës së kostove administrative dhe operative në raport me totalin e shpenzimeve.

Në përmbledhje, viti 2024 u karakterizua nga rritje e qëndrueshme e të ardhurave vendore, rritje e buxhetit për frymë, dhe ulje e detyrimeve financiare, por edhe nga reduktim i investimeve kapitale dhe efikasitet më i ulët buxhetor. Kjo tregon se bashkia ka forcuar bazën e të ardhurave dhe disiplinën fiskale, por ka nevojë të përmirësojë ekzekutimin e buxhetit dhe orientimin drejt investimeve zhvillimore për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe të



Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	2360890.00	2927822.00	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	341425.00	344245.00	Numër
Transferrat gjithsej, fakt	2051438.00	2393134.00	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	4412328.00	5320957.00	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	3547116.00	3826739.00	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	331375.00	515238.00	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	4679747.00	5331761.00	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	842569.00	773398.00	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	309510.00	39606.00	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	1469624.00	1641642.00	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	1234923.00	1411698.00	Mijë Leke

Lista e detajuar (e përmbledhur)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/ person	6914.81	8505.05	1590.24	↑	Përmirësuar	🟢	23%
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	115.08	122.34	7.26	↑	Përmirësuar	🟢	6%
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	53.51	55.02	1.52	↑	Përmirësuar	🟢	3%
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	80.39	71.92	-8.47	↓	Përkeqësuar	🔴	-11%
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	14.04	17.60	3.56	↑	Përmirësuar	🟢	25%
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/ person	13706.52	15488.27	1781.76	↑	Përmirësuar	🟢	13%
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	75.80	71.77	-4.02	↓	Përkeqësuar	🔴	-5%
Tregues	Investime për frymë	leke/ person	2467.80	2246.65	-221.15	↓	Përkeqësuar	🔴	-9%
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	23.75	20.21	-3.54	↓	Përkeqësuar	🔴	-15%
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	8.73	1.03	-7.69	↓	Përkeqësuar	🔴	-88%
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	41.43	42.90	1.47	↑	Përmirësuar	🟢	4%
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	34.81	36.89	2.08	↑	Përmirësuar	🟢	6%

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Performanca e bashkisë në 11 fushat e analizuara tregon një tablo përgjithësisht përmirësuese në ofrimin e shërbimeve bazë dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, por edhe disa dobësi të rëndësishme strukturore që kërkojnë adresim prioritar. Në shumicën e fushave vërehen trende pozitive – veçanërisht në arsim, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen nga zjarri, menaxhimin financiar dhe zhvillimin e burimeve njerëzore – ndërsa stagnimi në administrimin e pyjeve e kullotave, rënia e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, ulja e investimeve dhe dobësitë në konsultimin publik e barazinë gjinore në nivelet drejtuese sinjalizojnë nevojën për një rikalibrim të politikave vendore.

Në fushën e **arsimit parauniversitar** evidentohet një progres i qartë si në akses, ashtu edhe në cilësi: rritje e ndjeshme e shkallës së regjistrimit në çerdhe dhe kopshte, përmirësim i raportit fëmijë-mësues në institucionet publike dhe rritje e numrit të godinave arsimore. Në **menaxhimin e mbetjeve**, mbulimi i popullsisë është 100% dhe niveli i mbetjeve për banor

mbetet stabël, ndërsa mbulimi i kostos së shërbimit nga tarifa ka një rritje modeste, por ende niveli i vetëfinancimit është i ulët. **Mbrojtja nga zjarri** paraqet një histori suksesi, me rritje të numrit të zjarrfikësve dhe mjeteve për banor, çka përmirëson dukshëm kapacitetin e reagimit emergjent. Përkundrazi, **pyjet dhe kullotat** mbeten në status quo: mungesë plani vendor mbarështimi dhe pa rritje të stafit për njësi sipërfaqeje. Në **ujitje dhe kullim**, ndonëse sipërfaqja e mbuluar me kanale nuk është zgjeruar, përqindja e kanaleve funksionale është rritur dukshëm, duke dëshmuar fokus në mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese.

Fusha e **mbrojtjes sociale** shfaq një profil të përzier: nga njëra anë rritet ndjeshëm përfshirja në ndihmë ekonomike, përmirësohet shkalla e miratimit të strehimit social dhe rritet efektiviteti i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës, veçanërisht për gratë. **Burimet njerëzore** tregojnë rritje të numrit të punonjësve për 1000 banorë dhe një rritje shumë të fortë në përqindjen e stafit të trajnuar, veçanërisht në njësitë shpenzuese, çka forcon kapacitetet teknike dhe operacionale. Megjithatë, rritja e rotacionit të stafit (sidomos tek gratë dhe në njësitë shpenzuese) sugjeron mungesë stabiliteti dhe nevojë për politika më të mira mbajtjeje dhe motivimi.

Në dimensionin e **qeverisjes së mirë, transparencës** paraqet një kombinim qëndrueshmërie dhe rënije: raporti vjetor i transparencës dhe plani i integritetit vijnë të jenë në fuqi, por përqindja e akteve për të cilat është zhvilluar konsultim publik ka rënë, duke dëmtuar cilësinë e pjesëmarrjes qytetare. **Barazia gjinore** tregon përparim në përfaqësimin e grave në pozicionet politike dhe përfaqësuese (këshill bashkiak, drejtim politik), por një ulje në përfaqësimin e grave në pozicionet drejtuese administrative (të larta, të mesme, të ulëta), ku numri i grave në role ekzekutive është përgjysmuar. Në fushën e **integritetit në BE**, krijimi i komisioneve të integritetit pranë këshillit bashkiak është një hap pozitiv drejt institucionalizimit të procesit, ndërsa mungesa e marrëveshjeve ndërbashkiake, planeve për migracionin dhe diasporën, si dhe stagnimi në numrin e projekteve të BE-së të fituara tregon se potenciali i bashkisë për të përthithur më shumë fonde dhe partneritete ndërkombëtare mbetet i pashfrytëzuar plotësisht.

Analiza e **menaxhimit financiar** nxjerr në pah një bazë më të fortë fiskale, me rritje të të ardhurave vetjake për frymë, rritje të buxhetit për frymë dhe përmirësim të raportit të të ardhurave vetjake ndaj transfertave.

Rekomandime

Pyje/Kullota:

- Hartim dhe miratim i planit të mbarështimit;
- Rekomandohet që bashkia të vlerësojë rritjen e kapaciteteve njerëzore ose specializimin e stafit ekzistues, në mënyrë që menaxhimi i pyjeve dhe kullotave të kryhet me ngarkesë më të balancuar dhe mbikëqyrje më efektive të territorit.

Mbrojtja sociale/PAK:

- Rikthimi dhe forcimi i paketës së mbështetjes së integruar për personat dhe familjet në nevojë, duke siguruar që shërbimet sociale, ekonomike, shëndetësore dhe të këshillimit të ofrohen në mënyrë të koordinuar dhe të drejtuar nga nevojat individuale.
- Zgjerimi i rrjetit të qendrave komunitare në bashki, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse, me qëllim rritjen e aksesit në shërbime sociale të decentralizuara dhe të orientuara drejt komunitetit
- Operationalizimi i plotë i skemës së strehimit social, duke garantuar funksionalitet të plotë të mekanizmave të identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit të rasteve.

Burimet njerëzore

- Investimi në trajnime dhe zhvillim profesional, për të siguruar ruajtjen e stafit afatgjatë dhe krijimin e një baze të qëndrueshme kompetencash në administratë.

Transparenca

- Të sigurohet realizimi 100% i procesit të konsultimit publik, duke përfshirë publikimin e kalendarit vjetor, mbajtjen e protokolleve të konsultimeve dhe publikimin e evidencave të pjesëmarrjes për çdo nismë vendimmarrëse.

Barazia gjinore

- Zbatimi i kuotave dhe programeve të mentorimit për rritjen e pjesëmarrjes së grave në rolet drejtuese.
- Integrimi i buxhetimit të ndjeshëm gjinor në programet vendore për të siguruar shpërndarje të drejtë të burimeve.
- Vendosja e një mekanizmi monitorimi periodik për të vlerësuar nivelin e përfaqësimit gjinor dhe progresin në kohë.

Financa

- Përmirësim i parashikimit/ekzekutimit; riorientim i shpenzimeve drejt investimeve produktive; zgjerim i bazës së taksës së pasurisë; ruajtje e disiplinës ndaj detyrimeve.

Integrimi në BE

- Rritja e funksionalitetit të komisioneve të integritetit, duke i aktivizuar si mekanizma operacionalë pune për koordinimin me sektorët, mbledhjen e evidencave dhe raportimin sistematik të progresit.
- Krijimi i konsorciumeve ndërbashkiake dhe partneriteteve me sektorin privat, me qëllim rritjen e kapaciteteve konkurruese dhe përthithjen më efektive të fondeve dhe programeve të BE-së.